



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

CSDG

Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes

QENDRA PËR STUDIMIN E
DEMOKRACISË DHE QEVERISJES

NR. 2956/ PROT DATË, 18.11. 2025

NR. _____ PROT DATË, _____. 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

&

QENDRA PËR STUDIMIN E DEMOKRACISË DHE QEVERISJES

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, si institucion publik me statusin "Person Juridik Publik" përfaqësuar nga **Prof. Dr. Aurela Saliaj në cilësinë e Rektorit** sipërfaqësuesi ligjor për çështjet akademike dhe protokollare dhe autoriteti më i lartë akademik,

&

Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, **përfaqësuar nga z. Arjan Dyrmishi në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv.**

Me qëllim të bashkëpunimit, mirëkuptimit dhe kontributit të ndërsjelltë të Palëve, është të sigurojë një kornizë bashkëveprimi mes Palëve, në kuadër të përcaktimit të fushave dhe mënyrave të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve të sipërsënuara, në mënyrë që të operojnë me efikasitet në kuadër të aktiviteteve dhe nismave të ndërmarrpalët bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë "**Marrëveshja**")



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim, bashkëpunimin ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, në kuadër të përcaktimit të fushave dhe mënyrave të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve të sipërshënuara, në mënyrë që të operojnë me efikasitet në kuadër të aktiviteteve dhe nismave të ndërmarra. Të dyja këto institucione do të kenë qëllim të përbashkët identifikimin e iniciativave për promovimin dhe mbështetjen profesionale, në mënyrë që të operojnë me efikasitet dhe produktivitet.

Neni 2

Baza ligjore

Në zbatim të ligjit 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 3 , pika 4 ,germa c dhe të ligjit nr. 8788, date 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar .

Neni 3

Mënyra e Bashkëpunimit

Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin e ndërsjelltë ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes:

- Organizimin e konferencave, takimeve, seminareve dhe tryezave të rrubullakëta në të cilat trajtohen çështje me interes të përbashkët.
- Pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme të zhvilluara nga secila palë, sidomos me përfshirjen aktive të studentëve.
- Ndërmarrjen e çdo iniciative me interes të ndërsjelltë, si dhe me përfshirjen edhe të aktorëve të tjerë nga akademika dhe shoqëria civile.
- Promovimin e nismave apo projekteve të inicuar nga studentë dhe forcimin e bashkëpunimit të mëtejshëm

Neni 4

Detyrimet e palëve

Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes bien dakord të marrin përsipër:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Palët njohin dhe pranojnë rëndësinë e komunikimit aktiv, bashkëpunimit dhe koordinimit të vazhdueshëm ndërmjet tyre për zbatimin efektiv të aktiviteteve dhe iniciativave të përbashkëta, me qëllim sigurimin e një menaxhimi të suksesshëm të tyre dhe arritjen e rezultateve e objektivave të parashikuara

Neni 5

Respektimi i marrëveshjes

Institucionet bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshjesh të punës, motit të keq, “Fuqisë Madhore” ose shkaqeve të tjera objektive të cilat janë të pashmangshme, shkaktuar përtej mundësisë që kanë ato për t’i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse institucionet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi e tyre nuk do të konsiderohet si prishje e Marrëveshjes.

Neni 6

Mirëbesimi

- Kjo Marrëveshje nuk mund të jetë pjesë e ndonjë konflikti gjyqësor.
- Çdo keqkuptim apo mosmarrëveshje që mund të lindë mes Palëve, do të zgjidhet me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet Palëve, deri në gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët.
- Palët kanë detyrimin të sillen me korrektësi kundrejt njëra-tjetrës. Kjo nënkupton përveç të tjerave, që palët gjatë përmbushjes së detyrimeve të tyre reciproke dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre, të mos cenojnë interesat e njëra-tjetrës.
- Palët lidhin këtë Marrëveshje me qëllim respektimin e të gjitha dispozitave bazuar në parime të integritetit, pavarësisë dhe lirisë nga kritika e njëanshme për bashkëpunimin e Palëve dhe ruajtjes së reputacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Afati i marrëveshjes

- 1.Kjo marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje 3(tre) vjeçare nga data e nënshkrimit
- 2.Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim.
- 3.Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila palë, nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, të paktën 6(gjashtë) muaj përpara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 8

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Kjo marrëveshje është hartuar në 3(tre) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga 1(një) kopje do të depozitohen në Rektoratin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, 1(një) kopje do të depozitohen në Fakultetin e Shkencave Humane dhe 1 (një) kopje do të depozitohet në Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes.

PËR

PËR

UNIVERSITETIN

**QENDRA PËR STUDIMIN E
DEMOKRACISË DHE QEVERISJES**

"ISMAIL QEMALI" VLORE

REKTOR

PROF. DR. AURELA SALIAJ

DREJTOR EKZEKUTIV

ARJAN DYRMISHI

